

1. Përmbajtje ekzekutive mbi statusin e të drejtave të personave LGBT në Shqipëri 2016

Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT gjatë vitit 2016 ka identifikuar format më të përhapura të diskriminimit dhe target grupet më vulnerabël bazuar në rastet që raportohen nga anëtarët e komunitetit në zyrat e saj . Anëtarët e komunitetit që frekuentojnë qendrën e Aleancës janë të moshës mes 18 dhe 26 vjec dhe kryesisht e identifikojnë veten si homoseksual, transeksual dhe lezbike.

Deri në dhjetor 2016 ka pasur **532** raste të raportuara të dhunës psikologjike. Dhuna psikologjike përfshin: fyerje, ofendime, etiketime, poshtërim në rrugë dhe përjashtimi nga transporti publik, bare, palestra, supermarkete. Vetëm **5** nga këto raste janë raportuar tek autoritetet. Kjo ndodh kryesisht si pasojë e mungesës së besimit nga pjesëtarët e komunitetit në institucionet shtetërore dhe nga frika që mos kthehen në target diskriminimi nga vetë punonjësit e këtyre institucioneve si në rastin e Policisë së Shtetit. Në **5** nga rastet e raportuara anëtarët e komunitetit kanë hasur armiqësi nga oficerët e policisë. Vetëm, në një rast është raportuar se oficeri i policisë ka qenë neutral në veprimet e tij. Ka pasur **8** raste të dhunës fizike të raportuara tek Aleanca përfshirë rrahje, goditje me shkelma dhe shuplaka. Vetëm një rast është raportuar tek autoritetet.

Diskriminimi në vendet e punës

47 raste të diskriminimit në vendet e punës dhe / ose diskriminim në rekrutim dhe përzgjedhje janë raportuar pranë Aleancës. Aleanca ka spikatur vështirësitë e mëposhtme në vendin e punës: Ka raste që personat LGBTI kanë vështirësi në gjetjen e punës për shkak të stigmës dhe paragjykit, duke përjetuar ngacmime seksuale në bazë të orientimit seksual gjatë intervistave të punës dhe duke u pushuar nga puna për shkak se punëdhënësi ka zbuluar orientimin seksual të punëmarrësit. Anëtarët e komunitetit LGBT që janë në marrëdhënie pune kanë raportuar se përjetojnë tallje, fyerje, ofendime nga kolegët në vendet e punës. Shumë prej anëtarëve të komunitetit LGBT e kanë të vështirë të menaxhojnë këto situata dhe një **(1)** rast është larguar nga puna.

Aleanca ka regjistruar **13** raste diskriminimi kur persona të komunitetit LGBTI i janë drejtuar shërbimit shëndetësor. Në **1** rast, një anëtar i komunitetit LGBTI nuk pati akses për të marrë shërbimin shëndetësor që i nevojitej. Ky rast mori shërbimin e duhur vetëm pasi u shoqërua nga një përfaqësues i Aleancës . Në **1** rast tjetër një anëtar i komunitetit LGBTI raportoi se të gjithë e njihnin orientimin e tij seksual në qytetin ku ai jetonte dhe për këtë arsye nuk kishte pasur akses në sistemin e kujdesit shëndetësor. Në raste të tjera personat LGBTI raportuan se ishin diskriminuar dhe se ata mendonin se mjekët i paragjykonin.

- **Dhuna në Familje**

Dhuna në familje mbetet problematike brenda komunitetit LGBTI. Raste të dhunës në familje janë shumë të shpeshta për anëtarët e komunitetit LGBTI. Në 2016, **12** raste të dhunës në familje i janë raportuar Aleancës, të gjitha rastet e raportuara kanë përjetuar dhunë psikologjike nga prindër që mendonin se fëmija e tyre mund të ishte gej ose lezbike. Shtatë (**7**) anëtarë të komunitetit LGBTI raportuan se përveç dhunës psikologjike i janë nënshtruar dhunës fizike nga familja e tyre kur këta të fundit kishin zbuluar se fëmijët e tyre kishin orientim seksual LGBT. Aleanca kundër Diskriminimit LGBT pasi ka vlerësuar situatën e dhunës së ushtuar dhe shkallën e rrezikut që u kanosej personave të komunitetit për shkak të orientimit seksual ka ofruar mbështetje psikologjike. Gjithashtu sipas specifikave të cdo rasti të paraqitur dhe vlerësuar personat janë drejtuar / referuar tek shërbimet që plotësojnë nevojat e tyre si denoncimi i situatës së dhunës në polici, dhe drejt organizatave që ofrojnë shërbime lidhur me nevojat e vlerësuara rast pas rasti. si p.sh STREHA, Të ndryshëm dhe të Barabartë,

Së fundmi, situata e përgjithshme e anëtarëve të komunitetit që raportojnë raste të dhunës dhe diskriminimit pranë qendrës Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTI tregon qartë se personat që përballen me diskriminim dhe dhunë në publik janë zakonisht meshkuj të moshës **17- 35**. Më së shumti diskriminimi dhe dhuna në publik targeton meshkujt të cilët janë më të dukshëm gej ose trans. Lezbiket përballen me diskriminim në publik vetëm atëherë kur orientimi i tyre seksual ose identiteti gjinor është më i dukshëm. Në shumicën e rasteve personat e komunitetit përballen me dhunë verbale, por dhuna fizike është gjithashtu e shpeshtë. Femrat Transhjinore janë ato që përballen më shumë me dhunë fizike pasi identifikohen më lehtësisht që I përkasin komunitetit LGBT.

Një fenomen i cili gjatë vitit 2016 është rritur ndjeshëm është se shumë anëtarë të komunitetit LGBT janë angazhuar në punën e punonjësve të seksit. 11 anëtarë të komunitetit të cilët frekuentojnë rregullisht qendrën punojnë si punonjës seksi. Puna si punonjës seksi shihet prej anëtarëve të komunitetit si një mënyrë mbijetese për të siguruar të ardhura për veten dhe familjet e tyre. Familjarët nuk janë në dijeni të orientimit të tyre seksual, si dhe të punës që kryejnë, por janë të kënaqur nga ndihma financiare që u ofrohet duke qenë se jetojnë në qytete të vogla ku mundësitë e punësimit janë të pakta dhe ndihma financiare që ju ofrohet nga fëmijët e tyre në këto rrethana është shumë e vlefshme.

Personat që janë të angazhuar në këtë punë kanë arsim 9-vjecar dhe të mësëm, nuk kanë një profesion, nuk kanë eksperiencë pune të mëparshme, vijnë nga familje të varfra dhe kanë **1 – 3** vjet që kanë migruar në Tiranë.

Disa nga mënyrat e përfshirjes në këtë profesion janë nëpërmjet telefonit, rrjeteve sociale si facebook dhe në rrugë. Përveç zonës së ish gropës që njihet si zonë e frekuentuar nga punonjësit e seksit të komunitetit transgjinnor, tashmë është krijuar dhe një zonë e re zona e trenit (Blv. Zog I) që frekuentohet nga komuniteti i ri i punonjësve të seksit që marrin shërbime në Aleancën LGBT.

Krijimi i kësaj zone të re ka sjellë problematika ndërmjet vetë anëtareve të komunitetit, për shkak se punonjësit e vjetër të seksit e shohin grupin e ri të sapo krijuar si një kërcënim për punën e tyre dhe rënien e të ardhurave.

Nga komuniteti i punonjësve të seksit raportohen pothuajse përditë raste dhune dhe kërcënimi. Në **70%** të rasteve dhuna dhe kërcënim vjen nga banorët e zonës , 20% nga klientët e dhunshëm, dhe në **10%** te rasteve nga punonjësit e policisë të cilët kërkencojnë, dhunojnë dhe ofendojnë punonjësit e seksit. Për shkak të frikes se prostitucioni nuk është legal anëtarët e komunitetit hezitojnë ti denoncojnë rastet e dhunës në polici. Mungesa e sigurisë tek të rinjtë që punojnë si punonjës seksi ka shtuar frikën, ankthin, stresin në përballimin dhe menaxhimin e situatave të dhunës.

Emigrimi i komunitetit si një mundësi drejt punësimit

Gjithashtu gjatë vitit 2016 kemi dokumentuar **17** raste të komunitetit LGBT **6**(Trans), **3** (lesbikë), **8** homoseksual që kanë parë largimin nga Shqipëria si një alternativë drejt punësimit dhe përmirësimit të kushteve të jetesës dhe pranimit nga shoqëria.

Tetë (8) nga këto raste kanë statusin e azilkerkuesit në shtetet Francë, Suedi dhe Belgjike. Aleanca kundër Diskriminimit LGBT është përgjigjur duke dhënë informacione sipas kërkesave të zyrave të emigracionit, mbi situatën e komunitetit LGBT në Shqipëri, si dhe informacion mbi specifikat dhe historitë personale që lidhen kryesisht me diskriminimin nga shoqëria, dhunën në familje, bullizmin apo diskriminimin në vendet e punës.

Nëntë **(9)** raste e kanë vlerësuar emigrimin si një mundësi për të rritur të ardhurat dhe mbështetur familjen.

- **Aktivitetet tek qendra komunitare**

Menaxhimi i rasteve

Gjatë periudhës 2016 Aleanca ka mbështetur **19 raste** (5 transgjinnorë, 4 lesbikë, 10 gay). Për secilin nga rastet është kryer një vlerësim fillestar që lidhet me shkallën e rrezikut dhe

kërcënimeve për shkak të orientimit seksual të shfaqur apo të kuptuar nga rrethi familjar dhe komuniteti dhe me pas një vlerësim i plotë që lidhet me plotësimin e nevojave dhe fuqizimin e personave të komunitetit LGBTI.

Bazuar në vlerësimet e kryera për çdo rast, mbështja e ofruar ka qenë siguria për jetën (rastet me rrezik të lartë janë sistemuar në shërbimin STREHA), gjithashtu është ofruar mbështetje për rimbursim medikamentesh; shoqërimi i rasteve të komunitetit LGBT në komisariate; qendra shëndetësore apo spitale; zyrat e punës; (kur personat kanë hezituuar të marrin shërbimet e këtyre institucioneve për shkak të frikës nga diskriminimi, për shkak të situatave diskriminuese të ndodhura më parë) mundësi punësimi; informacion dhe orientim për pajisje me kartë identiteti, pasaportë, lëvizjen zyrtare nga një qytet në tjetër, regjistrimin në zyrat e punës, regjistrimin pranë kurseve profesionale, krijimin e CV; këshillim individual dhe në grup.

Aleanca kundër Diskriminimit LGBT u është drejtuar strukturave shtetërore në nivel rajonal dhe lokal për të adresuar problemet e komunitetit LGBT sipas nevojave të rasteve të paraqitura, konkretisht është bashkëpunuar me Komisarariatet e Policisë në Tiranë; Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve Pogradec, Psikologë Shkollash, Drejtorinë e Kujdesit Social dhe Drejtorinë e Strehimit, pranë bashkisë Tiranë.

Trajnime /Diskutime

Gjatë vitit 2016 në qendrën e Aleancës kundër diskriminimit LGBT çdo ditë të enjte janë zhvilluar trajnime/tema diskutimi të ndryshme për anëtarët e komunitetit mbështetur në nevojat e komunitetit, sfidat që ndeshin për t'u pranuar në shoqëri si individ me të drejta të barabarta. Temat e trajnimeve të zhvilluara përgjatë vitit 2016 lidhur kanë qenë : Menaxhimi i inatit dhe i zemërimit; Të drejtat e njeriut dhe si lidhen ato me Të drejtat e komunitetit LGBT; Roli i avokatit të popullit; E drejta e ankimimit pranë këtij institucioni; Te drejtat e punonjësve të seksit; Problemet e punonjësve të seksit; Siguria e punonjësve të seksit; Menaxhimi i situatave të dhunës, kërcënimit nga klientët; IST; HIV AIDS dhe Punonjësit e seksit; Përballja me problemet e komunitetit LGBT në Shqipëri; Urdhri i mbrojtjes dhe ligji për dhunën në familje; Çfare duhet të konsiderojmë kur bëjme coming out;

Temat e diskutimit janë një aktivitet i rëndësishëm për komunitetin. Përveçse këto tema kanë ndihmuar në informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të tyre në çështje të caktuara, ato shërbejnë për fuqizimin e komunitetit, si psh në rastet kur përballen me diskriminimin, dhunën në familje, mungesën e aksesit në shërbime për shkak të orientimit seksual duke adresuar çështjet pranë institucioneve dhe profesionistëve të duhur dhe kërkuar respektimin e të drejtave që u janë cënuar.

Metodologjia e trajnimeve ka qenë punë individuale dhe në grup; lojë rolesh; ndarja e eksperiencave personale apo miqve .

Këshillim dhe Orientim drejt Punësimit

Përgjatë gjithë vitit 2016 jemi përqëndruar të ndihmojmë komunitetin për të përmirësuar aftësitë teorike dhe praktike se si të paraqesin veten në një intervistë për punë dhe njëkohësisht të gjithë të rinjtë që frekuentojnë qendrën janë orientuar se si të regjistrohen në zyrën e punës, si të marrin pjesë në trajnime/kurse profesionale, si të kërkojnë punë përmes portaleve të ndryshme online. Gjatë 2016 kemi punuar me të gjithë të rinjtë që nuk kanë patur një CV dhe i kemi mësuar ata se si të ndërtojnë një të tillë apo se si ta përditësojnë . **30** CV janë përgatitur dhe përditësuar; 26 raste kanë aplikuar për vende pune; **5** persona nga komuniteti nëpërmjet ndërmjetësimit të Aleancës kundër diskriminimit LGBT janë punësuar ; gjithashtu të gjithë anëtarët e komunitetit janë informuar mbi mundësitë e reja të punësimit në mënyrë të përjavshme;

Bashkëpunimet me organizatat

Gjatë këtij viti kemi bashkëpunuar me organizatën STOP AIDS janë zhvilluar 5 aktivitete ndërgjegjësuere me të rinjtë e komunitetit me eksperte në fushën e semundjeve seksualisht të transmetueshme. Aktivitetet janë fokusuar tek menyrat e transmetimit dhe mbrojtja nga HIV Aids dhe IST-te. Llojet e infeksioneve seksualisht të transmetueshme; parandalimi dhe trajtimi. Nëpërmjet bashkëpunimit me Aksion plus dhe Stop AIDS anëtarëve të komunitetit ju është dhënë mundësia të kryejnë analizat për IST, pranë këtyre organizatave. 1 rast ka rezultuar HIV pozitiv.

Një organizatë tjetër me të cilën kemi bashkëpunuar për të rritur ndërgjegjësimin e të rinjve drejt kurseve profesionale është Dev AID. Janë zhvilluar 2 takime me përfaqësues të komunitetit dhe stafin e kësaj organizate pranë Aleancës kundër diskriminimit LGBT. Të rinjtë e komunitetit LGBT janë informuar mbi kurset profesionale falas që zhvillohen në Tiranë.

Aksesi në shërbime

Strehimi

Të gjithë të rinjtë e komunitetit janë të informuar mbi programet e strehimit që aplikohen në Bashkinë e Tiranës. Duke qenë se personat e komunitetit LGBT që frekuentojnë Aleancën janë banorë të regjistruar në rrethet të ndryshme të Shqipërisë nuk mund të përfitojnë nga këto programe.

Gjatë këtij viti Aleanca kundër diskriminimit LGBT ka ndihmuar për të gjetur shtëpi me qera përmes portaleve online dhe gazetës Celësi 60 persona të komunitetit. Vihet re një tendencë levizje e shpeshtë nga banesat me qera, për shkak se pronarët e shtëpive janë persona homofob.

Shëndetësi

Anëtarët e komunitetit LGBT kanë akses vetëm në shërbimin e urgjencës, i cili jepet falas. Për shkak se janë banorë të qyteteve të tjera në shërbimin shëndetësor ambulator kanë akses kundrejt tarifave të përcaktuara nga shteti.


Kjo situatë ndikon në mosndjekjen e semundshmërisë dhe agravimin e saj. Gjithashtu ndjekja shëndetësore e personave Trans behet përmes shoqërimit nga ana e stafit të Aleances, pasi vihet re që mjeket janë homofob kundrejt tyre.

- **Identifikimi i rasteve të diskriminimit ndaj komunitetin LGBT**

Gjatë muajve shtator-dhjetor 2016, Aleanca realizoi një pyetësor online lidhur me identifikimin rasteve të diskriminimit ndaj komunitetin LGBT. Pyetësi është plotësuar nga 78 persona të komunitetit LGBT. 41,3% e personave të komunitetit LGBT që janë pjesë e pyetësit e konsiderojnë veten meshkuj homoseksual, 20.51% lesbike, 16.67% femra biseksuale, 10.26% meshkuj biseksual, dhe 1.28% transgender.

Si e identifikoni veten?


Answered: 78 Skipped: 0



Answer Choices	Responses	
Lesbike	20.51%	16
Mashkull homoseksual	41.03%	32
Femer biseksuale	16.67%	13
Mashkull biseksual	10.26%	8
Transgender	1.28%	1
Tjeter	7.69%	6
Other (please specify)	2.56%	2
Total		
		78

MOSHA

Përsa I përket grupmoshës së personave që janë përgjigjur këtij pyetësi, vihet re se grupmosha 18 – 25 vjeç ka qenë e angazhuar me 63.16%; grupmosha 26 – 35 vjeç ka qenë e angazhuar me 25% dhe 36 – 45 vjeç me 11.84%. Nga të dhënat vihet re që personat e grupmoshës 18 – 25 vjeç kanë qenë më shumë të angazhuar krahasuar me grupmoshat e tjera, kjo grupmoshë përkon edhe grupmoshën e personave që marrin shërbime ditore dhe frekuentojnë aktivitetet pranë Aleancës LGBT.




ARSIMI

Vihet re që nga personat që janë përgjigjur më së shumti kanë përfunduar apo janë në ndjekje të arsimit të lartë dhe të mesëm. 43.59% kanë përfunduar apo janë në ndjekje të arsimit të lartë dhe 21.79% kanë përfunduar arsimin e mesëm.


**Ju lutem shenoni nivelin arsimor qe keni
perfunduar apo jeni duke kryer:**

Answered: 78 Skipped: 0



Answer Choices	Responses	
nuk jam shkolluar	1.28%	1
i ulet/ vetem shkolla fillore	1.28%	1
9 - vjecar	2.56%	2
i mesem i pergjithshem	21.79%	17
i mesem profesional	10.26%	8
i larte	43.59%	34
master	15.38%	12
doktorature	3.85%	3
Total		78

PUNESIMI




Vihet re se personat e komunitetit LGBT që janë përgjigjur pyetësorit 54.55% janë të papunësuar, ndërsa 45.45% janë të punësuar.

DHUNA PSIKOLOGJIKE

A ju ka ndodhur gjate ketij viti (2016),qe per shkak te orientimit tuaj seksual t'u: *mund te perzgjidhni me shume se nje opsion

Answered: 66 Skipped: 12




Answer Choices	Responses
ofendojne	36.36% 24
poshterojne	21.21% 14
tallin	36.36% 24
thurin thashetheme dashakeqe	42.42% 28
kercenojne ne facebook, email, blog	21.21% 14
izolojne	9.09% 6
shantazhojne	4.55% 3
demtojne ose vjedhin pronen/sendet tuaja personale	3.03% 2
rrahin	6.06% 4
shkelmojne	3.03% 2
shtyjne, godasin, terheqin	9.09% 6
sulmojne me arme apo sende te forta	1.52% 1
ngacmuar seksualisht /prekur kunder deshires suaj	9.09% 6
ngacmuar seksualisht/ perdhunim ose perdhunim mbetur ne tentative	4.55% 3
drogojne kunder deshires tuaj	0.00% 0
shfrytezojne per te kryer mardhenie seksuale kundrejt pagesave	4.55% 3
tjeter	15.15% 10

Thashethemet dashakeqe me 42.42% mbizotërojnë si sjellje kundrejt presonave të komunitetit LGBT, vijohet me ofendimet 36.36% , poshtërimet dhe kërcënimet ne facebook, email dhe blog 21.21%. Fenomeni I kercenimeve në facebook është shtuar përgjatë vitit 2016, pasi shumë portale online kanë nxjerr në pah orientimin seksual të komunitetit LGBT.

N.q.s po kjo situatë ka ndodhur ne:

Answered: 61 Skipped: 17




Answer Choices	Responses	
familje	19.67%	12
tek te afermit	16.39%	10
lagje	24.59%	15
shkolle	26.23%	16
qender interneti	4.92%	3
lokal, bar, restorant	11.48%	7
pub, disko	6.56%	4
lulishte, parqe	9.84%	6
autobuz	6.56%	4
taxi	3.28%	2
vendin e punes	9.84%	6
gjate intervistave te punes	9.84%	6
urgjence/ qender shendetesore/spital	1.64%	1
policia	6.56%	4
ne rruge	27.87%	17
tjeter	36.07%	22
Total Respondents: 61		

Më së shumti dhuna psikologjike përjetohet në rrugë 27.87%, në shkollë 26.23, në lagje me 24.59% dhe në familje 19.67%. Këto të dhëna shpjegojnë edhe dëshirën e antëtarëve të komunitetit për të ndryshuar vendbanimin, për t'u larguar nga familja apo qyteti ku jetojnë.

Raportimi I situatave të dhunës

A e keni raportuar incidentin ne polici?


Answered: 68 Skipped: 10



Answer Choices	Responses	
Po	7.35%	5
Jo	92.65%	63
Total		68

Nese po cili ishte reagimi i policise?


Answered: 37 Skipped: 41




Answer Choices	Responses
Mbeshtetes	2.70% 1
Asnjanes	13.51% 5
Armiqesor	16.22% 6
Tjeter	54.05% 20
Other (please specify)	13.51% 5
Total	37

92.65% e anetareve të komunitetit nuk kanë raportuar situatat e dhunës në polici, vetëm 7.35% e tyre kanë bërë një raportim për incidentet që kanë pësuar. Vërehet një përqindje e lartë e rasteve që nuk janë raportuar, që lidhet kryesisht me reagimin armiqësor të punonjësve të policisë.

Nese Jo, cilit institucion apo organizate i drejtoheni ne rastet e situatave te dhunes dhe diskriminimit per shkak te orientimit seksual apo identitetit gjinor:



49.12% e personave janë të informuar për shërbimet që ofron Aleanca dhe kanë preferuar të bëjnë denoncimin e rasteve të dhunes përmes Aleancës. 17.54% janë të informuar për zyrën dhe shërbimet që ofron komisionerja kundër diskriminimit, pjesa tjetër 5.26% në rastet e raportimit të dhunës mendojnë se duhet të drejtohen tek Avokati I Popullit. Të dhënat tregojnë se personat e komunitetit LGBT janë në dijeni të institucioneve ku mund të ankimohen.



46.75% e anëtarëve të komunitetit nuk e ndjejnë aspak të pranuar, të mbështetur dhe të respektuar, ndërsa vetëm 3.90% e personave që kanë plotësuar këtë pyetësor mendojnë se respektohen dhe pranohen në Shqipëri.